



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE
PËRPUTHSHMËRISË PËR ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT
TË KUADRIT RREGULLATOR**

Nr. 4426 Prot.

Tiranë, më 12. 8.2021

Lënda: Mbi shtyrjen e afatit për kryerjen e procesit të lëvizjeve paralele në institucionet e arsimit parauniversitar

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, Durrës

Adresa: Lagja Nr. 12, Rruga "Mujo Ulqinaku", te Shkolla "Marie Kaçulini", Durrës

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, FIER

Adresa: Lagja "Kastriot", Rruga "Leon Rei", Fier

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, KORÇË

Adresa: Rruga "Dhimitër Denasi", Korçë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, LEZHË

Adresa: Sheshi "Gjergj Kastrioti", Lezhë

Për dijeni: **DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, vlerëson punën përgatitore dhe të gjitha masat e marra deri më tani nga të gjitha institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin prauniversitar lidhur me kryerjen e procedurave për regjistrimin e nxënësve dhe fillimin e vitit të ri shkollor 2021-2022, por duke qenë që procesi i regjistrimit të fëmijëve/nxënësve në institucionet e arsimit parauniversitar nuk ka përfunduar, për rrjedhim nuk mund të përcaktohet ende ngarkesa mësimore e mësuesve.

Po ashtu, duke marrë në konsideratë situatën epidemiologjike në vend, në varësi të skenarëve që do të aplikohen për zhvillimin e procesit mësimor në institucionet arsimore parauniversitare, bazuar në vendimet e Komitetit Teknik të Ekspertëve, në përputhje edhe me protokollin e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe

Instituti i Shëndetit Publik, në zbatim të legjislacionit në fuqi, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kërkon nga të gjitha institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin prauniversitar të marrin masa urgjente për shtyrjen e afatit të kryerjes së procesit të lëvizjeve paralele të mësuesve në institucionet e arsimit parauniversitar, për ta përfunduar këtë proces më datë 05 shtator 2021.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTRI

Evis KUSHI

